



ПРИЕМНА КАНАЦЕЛАРИЈА ЗГРАДНА ПИРАНИМИТ
Org. jed./Nj. org./Org. unit 0.A
Br. s./Nr.f./No.p./ 02-031 / Br./Nr./No./ 2022
Datum/Data/Date 28.02.2022

Republika Kosovo
Republika e Kosoves
Republic of Kosovo

Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12, paragrafit 12.2, pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3, 4 të Udhëzimit Administrativ për Komitetet Komunale për Siguri në Bashkësi nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme - 03/2012 MAPL, Neni 15, paragrafi 15.1 i Statutit të Komunës së Ranillugut Nr. 02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e parë të jashtëzakonshme të mbajtur më 28.02.2022 ka miratuar:

V E N D I M I N M B I **FORMIMIN E KOMITETIT KOMUNAL PËR SIGURI TË BASHKËSI**

1.

Propozimi kaloi në shqyrtimin kryesor të seancës së parë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Ranillugut, të mbajtur më 28.02.2022, ku u lejua dhe u miratua njëzëri.

2.

Miratohet Vendimi për themelimin e Komitetit për Siguri të Bashkësisë në këtë përbërje:

1. Kryetarja e komunës (Kryesues);
- 1.2 Komandant i Stacionit Policor Komunal të Ranillugut;
- 1.3 Një përfaqësues legjitim nga çdo bashkësi fetare në komunën e Ranillugut;
- 1.4 Një përfaqësues nga secila bashkësi etnike e komunës së Ranillugut;
- 1.5 Kryetari i Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Ranillugut;
- 1.6 Zyrtari për Barazi Gjinore;
- 1.7 Drejtori i Drejtorisë së Arsimit;
- 1.8 Kryetar i Këshillit të Prindërve për Arsim në Komunë;
- 1.9 Një përfaqësues i FSK-së;
- 1.10 Një përfaqësues nga çdo Këshill Lokal i Sigurisë Publike;
- 1.11 Kryesuesi i Ekipit të Veprimt për Sigurinë në Komunitet;
- 1.12 Një përfaqësues nga sektori komunal për Emergjencë;
- 1.13 Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
- 1.14 Një përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me aftësi të kufizuara;
- 1.15 Komandant i Policisë Kufitare në vendkalimin Dheu i Bardhë;
- 1.16 Shefi i Doganës në vendkalimin Dheu i Bardhë;
- 1.17 Përfaqësues i Vijës së Gjellbër;
- 1.18 Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë.

3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës së Ranillugut.

4.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Komunës.

Datë: 28.02.2022

Ranillug

Përktheu: Lazim Bajrami



Kryesuesi i K.K të Ranillugut

Ivan Krstiq